

NJOFTIMI I ANKANDI

1. Autoriteti shites: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Adresa : Rruga Kavajës, Kompleksi “Delijorgji”, Kulla C1, K.1, H.2, Tiranë.

Nr.tel : 00355 04 225 4071

2. Data e zhvillimit te ankandit 02.09.2025 ora 11:00

3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit Procedurë e Hapur.

4. Objekti i Shitjes: Pajisje, makineri dhe automjete të sekuestruara të shoqërisë “Energji –Kalivaç”

5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes:

Pajisjet dhe makineritë janë të vendosura në zonën e Kalivaçit, Tepelenë, konkretisht në kantierin e ndërtimit të hidrocentralit Kalivaç. Këto pasuri objekt ankandi janë pasuri të shoqërisë “Energji-Kalivaç” e cila është një shoqëri e sekuestruar. Brenda këtij kantieri ndodhen një sërë pajisjesh dhe makinerish që variojnë nga pajisje zyre dhe kancelarie deri te makineritë e rënda, përfshirë impiantin e prodhimit të betonit dhe mjete të ndryshme transporti. Këto mjete dhe pajisje nuk janë përdorur apo mirëmbajtur për një periudhë të gjatë kohe, që përkon me më shumë se një dekadë, çka ka ndikuar ndjeshëm në amortizimin e tyre të përgjithshëm dhe paraqesin një gjendje të rënduar fizike dhe teknike.

Shënim: Sqarime me të hollësishme do të jepen në “Dokumentat standarte të ankandit”.

6. Vlera fillestare :15 322 216 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë)lekë pa tvsh

Nr.	EMËRTIMI	Vlera fillestare lekë (pa TVSH)
1	Pajisje, makineri dhe automjete	15,322,216

Ankandi do të fillojë vetëm me kërkesat e paraqitura për blerjen e të gjithë sasisë së mallrave “Pajisje, makineri dhe automjete”, me vlefë totale prej 15 322 216 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e dy mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë)lekë pa tvsh.

Çdo person i interesuar për blerjen e mallrave objekt ankandi duhet të paraqesë;

1. Kërkesë me shkrim për blerjen në sasi dhe vlefë totale të mallrave “Pajisje, makineri dhe automjete.

2. Mandat pagesën apo garancinë bankare që verteton derdhjen apo ngurtësimin e 10% të vleftës së ankandit. Pagesa prej 10% e vleftës së ankandit, për pjesëmarrje në ankand është 1 532 221.6 (një milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e një pikë gjashtë)lekë, e cila do të kryhet në llogarinë bankare të AAPSK-së.

Shenim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili terhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 10% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie autorizimin për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

3. Dokumenta që vërteton që ka eksperiencë pune mbi tre vjet dhe disponon kontrata të ngjashme me objektin e ankandit.
4. Dokumenta që disponon makineri dhe paisje për kryerjen e procesve të punës (ngarkim transportim etj të mallarve objekt ankandi nga vendi ku janë) të vërtetohet me certifikata pronësie ose kontrata qiraje).
5. Dokumenta që vërtetojnë që ka punonjës të specializuar për kryerjen e proceseve të punës (çmontim apo demolim) të vërtetohet me kontratat e punës.

Shënim; Proçeset e punës si: (çmontimi apo demolimi i tyre, transporti apo ngarkimi në mjetet e transportit) i këtyre makineri e paisje do të realizohet nga kandidati fitues blerës i ankandit me punonjës të specializuar deri në pastrimin e plotë të zonës ku ndodhen

7. Vendi i zhvillimit të ankandit: (Adresa:) Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Adresa : Rruga Kavajës, Kompleksi “Delijorgji”, Kulla C1, K.1, H.2, Tiranë.

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 02.09.2025 ora 11:00

9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të trerhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo
<i>Nëse Po</i>	Monedha	lekë	Çmimi 6000

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.